



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

|                                   |                                  |
|-----------------------------------|----------------------------------|
| <b>Titulli i pozitës së punës</b> | Auditor i Brendshëm              |
| <b>Klasa e pozitës</b>            | Profesional 1                    |
| <b>Koeficienti/Paga</b>           | Auditor i brendshëm/W 13/ 6.4    |
| <b>Nr. i kërkuar</b>              | 1                                |
| <b>Data e njoftimit</b>           | 23/06/2023                       |
| <b>Afati për aplikim</b>          | 10/07/2023 - 24/07/2023          |
| <b>Institucioni</b>               | Agjencia Kosovare e Privatizimit |
| <b>Departamenti</b>               | Njësia e Auditimit të Brendshëm  |
| <b>Divizioni</b>                  |                                  |
| <b>Vendi i punës</b>              | Prishtinë                        |
| <b>Nr. i Referencës</b>           | RN00011942                       |
| <b>Kodi</b>                       | RPC0005533                       |



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin, merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe planeve të punës;
- Në pajtueshmëri me Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, objektive të AKP-së, Statutin e NJAB-së, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm kryen të gjitha procedurat e auditimit të brendshëm;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë mbi përdorimin efektiv të resurseve të AKP-së, përpilon draft raporte, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutimet me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësisve organizative;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit sipas nevojës;
- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara për të gjitha entitetet e AKP-së (Departamentet, Njësitë, Zyrat Rajonale, etj.), duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve në AKP, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transaksionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilën qeveriset AKP-ja;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Udhëheqësit të Divizionit të Auditimit Brendshëm, apo vetë Njesisë;
- Me qëllim të dëshmoj se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Agjencisë dhe Njesisë së Auditimit Brendshëm, të marr pjesë në trajnime dhe në zhvillim të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për të mirëmbajtur, ruajtur certifikatën profesionale të auditimit të brendshëm;

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Ekonomi, specializimi Financa dhe/apo Kontabilitet, Juridik, Administratë publike;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale lidhur me fushëveprimin e pozitës;



## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Njohja e gjuhës angleze.

## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Aplikacioni i cili plotësohet online me rastin e aplikimit;
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;
- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dëshmi nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore që nuk është shuar ende;
- Letër motivimi;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 31/07/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- Zyra Qendrore AKP



## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Njohja e gjuhës angleze.

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

